

FJALA E DEPUTETIT XHEMAL QEFALIA

05 SHKURT 2024

E nderuar zonja Kryetare,

Në fakt kjo javë ka qenë një javë e rëndësishme, pasi ka të bëjë drejtpërdrejt me zgjidhjen e halleve të banorëve. Më lejoni që në emër të banorëve të zonës sime të falënderoj Ministrinë e Infrastrukturës që dha lajmin pozitiv për hapjen e tunelit të Murrizit!

Më lejoni njëkohësisht të them që vendosja e kabinave elektrike në zonën e Murrizit dhe në zonën e Vilzës është një tregues i përkujdesjes që ka kjo qeveri për qytetarët. Nisur për të sjellë disa nga shqetësimet, jam i bindur që banorët e kryeqytetit e shohin situatën reale se si është katandisur këtu: një opozitë e cila kërkon të gjejë të drejtat e saj për të marrë leadershipin dhe një mazhorancë që ka detyrat e saj.

Prandaj, të nderuar qytetarë, të jeni të bindur që ne do të vazhdojmë të jemi me ju për të përmbushur të gjitha objektivat që i kemi vënë vetes. Vetëm duke qenë së bashku do të adresojmë dhe do t'i realizojmë të gjitha objektivat, me bindjen e plotë që vëmendja dhe përkujdesja e kësaj qeverie do të shkojë te çdo qytetar, te çdo lagje dhe te çdo banor.

Faleminderit!